Ky studim shqyrton përpjekjet aktuale të qeverisë dhe institucioneve ndërkombëtare për të adresuar këto sfida, duke vlerësuar sukseset dhe pengesat në procesin e implementimit.

Pjesë e studimit janë edhe anketat e realizuara me qytetarë. .

Përmes një analize të thellë të kontekstit politik, ekonomik, dhe social në Kosovë, ky studim ofron rekomandime konkrete për zbatimin e politikave dhe strategjive të menaxhimit të shërbimeve shëndetësore në mënyrë që të sigurohet që popullata e Kosovës të ketë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore cilësore dhe të trajtohet me respekt dhe kujdes ndaj nevojave të tyre shëndetësore. Në përfundim, ky punim konkludon me një vlerësim të perspektivës së ardhshme të menaxhimit të shërbimeve shëndetësore në Kosovë dhe me identifikimin e sfidave dhe mundësive për zhvillim të mëtejshëm në këtë fushë.

Fjalët kyqe : Menaxhim, shëndetësi, strategji

LARGIMI I SIGURT I BARNAVE TË PAPËRDORSHME – SFIDË GLOBALE

Arlinda Haxhiu Zajmi

Hudhja adekuatë e barnave është thelbësore për mjedisin dhe shëndetin publik. Barnat e papërdorura ose me afat të skaduar mund të shkaktojnë probleme serioze nëse hudhen gabimisht, pasi që mund të ndotin burimet e ujit, të dëmtojnë mjedisin jetësorë si dhe të jenë të rrezikshme për grup moshë të caktuara të popullatës.

Aplikimi i procedurave përkatëse të largimit të barnave nga shtëpitë, jo vetëm që ka ndikim pozitiv në mbrojtjen e mjedisit por gjithashtu mund të ndikojë në zvogëlimin e problemit të abuzimit dhe keqpërdorimit të barnave si ato me recetë dhe OTC. Në shumë vende të BE si dhe në SHBA ekzistojnë procedura, programe për grumbullimin e barnave që nuk përdoren.

Një sërë palësh të interesuara dhe shoqata udhëheqin nismat nacionale në mbarë Evropën, për ta rritur ndërgjegjësimin e popullatës për rreziqet nga largimi i gabuar i barnave. Ndërgjegjësimi i popullatës është shumë me rëndësi dhe një sfidë globale, ku një prej faktorëve kyq në këtë drejtim është edhe angazhimi i farmacistëve dhe palëve tjera.

E gjithë kjo jo vetëm që mbron mjedisin, por gjithashtu kontribuon në një komunitet më të sigurt dhe më të shëndetshëm duke minimizuar rreziqet e mundshme që lidhen me mënyrën e gabuar të largimit të barnave nga shtëpitë.

Prandaj qëllimi i këtij punimi është analiza dhe rishikimi i literaturës profesionale dhe shkencore në lidhje me faktorët që ndikojnë në krijimin e stoqeve të barnave nëpër shtëpitë, të cilat nuk përdoren, pasojat nga të njëjtat kur nuk largohen si duhet, si dhe krahasimi i ligjeve, rregulloreve dhe praktikave në lidhje me definimin dhe menaxhimin me këto barna në vendet e ndryshme.

Fjalët kyçe: barnat e papërdorura, largimi, ndërgjegjësimi, rregullore, programe.

FITOTERAPIJA E PERSONALIZUAR, SFID PËR FARMACISTËT

Mehrixhana Dervishi Llazorja, Ulcinj, Monte Negro

Fitoterapia është një disiplinë mjekësore që përfshin përdorimin e bimëve mjekësore dhe preparateve bimore në trajtimin dhe parandalimin e sëmundjeve.

Cilësia dhe siguria e përdorimit të preparateve bimore mbeten një prioritet në dorën e farmacistit, që duhet të rregullohet ligjërisht në nivel shtetëror. Për regjistrimin e një preparati bimor si ilaç ka të njëjtat kërkesa si për regjistrimin e barnave të tjera për sa i përket dokumentacionit që duhet të përmbajë teste paraklinike dhe klinike.

Teste të tilla janë shumë kërkuese, dhe duke qenë se kompleksiteti i strukturës molekulare të bimëve paraqesin një sfid në vete, madje edhe i preparateve bimore me një përbërës, pengon vendosjen e kriterëve unike për monitorimin e qartë të efekteve terapeutike të tyre, përmbushja e kërkesave për regjistrimin e një ilaçi bimor. Në dorën e farmacistit mbetet dija dhe përvoja profesionale, gjithmonë e bazuar në fakte shkencore univerzitare dhe pasuniverzitare, si dhe literatura shkencore.

Ajo që duhet të cekim është që komplekset bimore sot janë disponueshme në shumë vende ku egziston rekomandimi profesional farmaceutik, madje edhe reklamohen pa kriterë duke rrezikuar shëndetin e pacientit. Këtu vjen në pozicionin e meritur këshilla e farmacistit, për një fitoterapi të personalizuar, në bazë të nevojave dhe kërkesave të individit, me siguri për pacientin dhe ngritjen e kompetencave profesionale të farmacistit në veçanti.

Fjalët kyçe: fitoterapi, fitoilaç, fitokompleks, farmacist, siguria e barnave bimore.

ANALIZA FARMAKOTERAPEUTIKE DHE NDËRVEPRIMET POTENCIALE MIDIS BARNAVE NË PACIENTËT ME HIPERTENSION ARTERIAL

Edita Alili-Idrizi

Hipertensioni si një shqetësim në rritje i shëndetit publik është sëmundje kronike që kërkon mjekim gjatë gjithë jetës. Ekzistojnë qasje të ndryshme farmakologjike për menaxhimin e tij dhe përshkrimi i duhur ka implikim pozitiv në përmirësimin e sëmundjes. Prandaj, qëllimi kryesor i këtij studimi është analiza farmakoterapeutike dhe vlerësimi i përshkrimit të antihipertensivës dhe ndërveprimeve të mundshme bar-bar në pacientët me hipertension arterial.

Ky është një studim ndër-seksional retrospektiv i bazuar në spital, i kryer nga marsi deri në gusht 2021. Një formular kontrolli i strukturuar u hartua bazuar në objektivin e studimit për nxjerrjen e të dhënave nga dosjet e pacientëve ambulatorë që shërbyen si burim informacioni.

Të gjithë pacientët me hipertension që marrin mjekim janë përfshirë. Nga 260 rastet e analizuar, 53,8% ishin femra, 86,2%, ishin ≥ 55 vjeç. Komorbiditetet më të shpeshta së bashku me hipertensionin ishin hiperlipidemia (13.5%) dhe diabeti mellitus (5.0%). Bisoprololi (19.4%), i ndjekur nga Losartan (14.9%) dhe Perindopril (14.2%) janë antihipertensivët më të përshkruar. Ilaçi me përqindjen më të lartë të përshkruar në përputhje me udhëzimin është Bisoprololi.

Ndërveprimet e moderuara të mundshme përbënin shumicën e ndërveprimeve medikamentoze në 64.4% të rasteve. Ndërveprimet midis Salbutamol dhe Carvedilol dhe midis Lisinopril dhe Losartan konsiderohen si ndërveprime potencialisht serioze. Komunikimi efektiv midis mjekëve, profesionistëve të tjerë të kujdesit shëndetësor dhe pacientëve është thelbësor në trajtimin e suksesshëm të hipertensionit.

Mësimi i vazhdueshëm, pjesëmarrja e personelit shëndetësor në trajnime, kongrese dhe konferenca do të rrisë nivelin e njohurive, për të qenë në hap me risitë dhe për të ofruar një shërbim më racional për pacientët. Identifikimi dhe monitorimi i ndërveprimeve të barnave ndihmon në formimin e një plani standard terapeutik.

Fjalët kyçe: Hipertension, antihipertensivë, analiza farmakoterapeutike, ndërveprime të mundshme bar-bar

VALIDIMI I METODIKËS PËR PËRCAKTIMIN CILËSOR DHE SASIOR PENICILLAMINËS NË KAPSULA ME XHELATINË TË FORTË

David Lekli

Hyrje. Penicillamina përdoret në trajtimin e sëmundjes nga mbingarkesa në bakër. Ky bar gjendet në treg në formën e kapsulave me xhelatinë të fortë të penicillaminës 250 mg. Për të bërë të mundur realizimin e testeve të kontrollit të cilësisë për këtë bar përdoret një metodikë që parashikon përdorimin e Kromatografisë së Lëngët me Performancë të Lartë. Qëllimi i këtij studimi është validimi i metodikës për përcaktimin sasior dhe identifikimin cilësor të Penicillaminës, me ndihmën e Kromatografisë së Lëngët me Performancë të Lartë të pajisur me Uv-DAD në gjatësi vale $\lambda=210$ nm.

Metodika. Vlefshmëria e kësaj metodike është testuar në kapsula me xhelatinë të fortë të Penicillaminës, në formë doze 250 mg. Është studiuar lineariteti i metodikës dhe zona e punës duke përgatitur shtatë tretësira të holluara në 1.0 g/L EDTA dinatrium në ujë, me përqendrimë të njohura (0.02 mg/ml deri në 1.25 mg/ml). Kushtet e eluimit isokratik me kolonë RP C18 (250mm x 4.6 mm x 5 μ m), me fazë lëvizëse 6.9 g/L natrium fosfat monobazik dhe 0.2 g/L natrium 1-hexan sulfonat të tretura në ujë, me vlerë të pH 3.0 ± 0.1 të përshtatura me H₃PO₄ të holluar. Shpejtësia e rrjedhjes 1 ml/min temperatura e kolonës dhe autosample t=25 0 C.

Rezultate dhe përfundime. Ekuacioni i linearitetit: $y=60.261x-0.3887$ dhe koeficienti i linearitetit $R^2 = 0.9998$, treguan për një linearitet të mirë dhe zonë pune të gjerë me vlera të ulëta të gabimeve sistematike. Kufiri i dedektimit dhe kufiri i përcaktimit u gjetën sipas formulave përkatëse, $LOD = 0.067$ mg/L dhe $LOQ = 0.073$ mg/L. Studimi i saktësisë dhe precizionit u testuan me 10 injektime të njëpasnjëshme prej të cilave u dhanë vlerat e $RSD = 0.17$ % për sipërfaqen e pikut. Numri teorik i pjatave $N = 3701.8$ dhe faktori i asimetrisë $fas = 0.91$. U vërtetua saktësia e ndërmjetme e metodës duke kryer matje nga dy analistë të ndryshëm në të njëjtat kushte, të cilat dhanë nivele të krahasueshme me vlera RSD % të afërta me njëra tjetrën (< 1 %) dhe vlerë të Kriterit të Fisherit $F = 0.6$. Rezultatet nga matjet ($n=24$) treguan se riprodhueshmëria dhe ripërsëritshmëria e uniformitetit të përmbajtjes është 99.46 % për nivel besueshmërie 95 % me vlerë të $RSD = 0.37$ %, dhe 99.15 % me vlerë të $RSD = 0.42$ %. Kjo metodë rezultoi selektive pasi veshja e kapsulës nuk ndikoi në pikun kryesor të Penicillaminës.

Fjalë kyçe: HPLC- DAD, Penicillaminë, RSD%, lineariteti, vlefshmëria, metodë.

ROLI I INOVACIONIT FARMACEUTIK NË KUJDESIN SHËNDETËSOR, PERSPEKTIVA DHE PARIME ETIKE

Ina Pasho

Hyrje:

Në peisazhin gjithnjë e në ndryshim të inovacionit farmaceutik, ky punim përfshin një sintezë të hollësishme të pikëpamjeve thelbësore në rrugën e përparimit të kujdesit shëndetësor global. Në qendër është roli i pamohueshëm i inovacionit në fushën farmaceutike, i cili jo vetëm çon përpara kufijtë shkencorë, por edhe kërkon investime të konsiderueshme, studime klinike rigorozë, dhe bashkëpunim të ngushtë mes palëve të ndryshme të interesit.

Metoda dhe materiali:

Një aspekt thelbësor është dimensionin etik i inovacionit, veçanërisht me rritjen e përdorimit të teknologjive, si inteligjenca artificiale (AI). Është domosdoshmëri që integrimi i saj të bëhet me përgjegjësi, duke u siguruar që konsideratat etike të mbeten në qendër të vëmendjes. Kjo ka të bëjë me zvogëlimin e rreziqeve të dehumanizimit dhe shkeljes së privatësisë, ndërkohë që maksimizohen përfitimet potenciale që AI ofron në përmirësimin e kujdesit shëndetësor.

Në këtë punim do të paraqesim gjithashtu rezultatet e nxjerra nga një studim mbi perspektivat e profesionistëve të kujdesit shëndetësor mbi inovacionin në fushën e mjekësisë. Ky studim zbulon një gamë të ndërlikuar të qëndrimeve ndaj inovacioneve dhe AI-së, ku ndërkohë që shumë prej tyre njohin potencialin e tyre transformues, ngrejnë shqetësime rreth ndikimit të saj në ndërveprimin njerëzor, privatësinë e pacientëve dhe çështjeve etike të lidhura me aplikimin e tyre.

Do të diskutojmë gjithashtu mbi parimet e propozuara brenda Bashkimit Evropian lidhur me inovacionin në tërësi. Këto parime promovojnë një qasje të shpejtë ndaj adaptimit të legjislativ, duke siguruar që inovacioni të përparojë ndërsa ruhet standardi i fortë i sigurisë dhe efikasitetit.

Konkluzione:

Në një kohë kur inovacioni në fushën farmaceutike po përparon me shkencën dhe teknologjinë, është shumë e rëndësishme të kujdesemi për aspektet etike të këtyre zhvillimeve. Bashkëpunimi dhe respektimi i vlerave etike janë thelbësore për të garantuar përparimin e qëndrueshëm të kujdesit shëndetësor.

Fjalë Kyce: Inovacioni farmaceutik, studime klinike, kujdesi shëndetësor, etika.

INOVACIONET E FUNDIT NË NANOENKAPSULIMIN E PËRBËRËSVE AKTIV NË KOZMETIKË

Venesa Lupçi

Qëllimi i Punimit:

Ky rishikim i literaturës synon të vlerësojë përdorimin e nanoenkapsulimit në kozmetikë, duke theksuar përparësitë dhe sfidat e kësaj teknologjie.

Materialet dhe Metodat:

U analizuan artikuj dhe studime të publikuara që trajtojnë përdorimin e nanoenkapsulimit për përbërës aktivë të ndryshëm kozmetikë, përfshirë vitaminat, antioksidantët dhe agjentët hidratues. U konsideruan metodat e enkapsulimit, efikasiteti në përthithjen e lëkurës, dhe impakti në stabilitetin e përbërësve.

Rezultatet:

Studimet tregojnë se nanoenkapsulimi rrit ndjeshëm stabilitetin e përbërësve dhe kontrollon mënyrën e çlirimit të tyre në lëkurë. Rezultatet sugjerojnë një përmirësim të dukshëm në efikasitetin e përbërësve nëpërmjet përthithjes më të lartë në shtresat e thella të lëkurës.

Përfundimi:

Nanoenkapsulimi ofron një mjet potencialisht të rëndësishëm për përgatitjet kozmetike, duke përmirësuar performancën e produktit përfundimtar. Hulumtimi i mëtejshëm është i nevojshëm për të adresuar çështjet e sigurisë dhe për të optimizuar teknologjitë e nanoenkapsulimit për aplikime të ardhshme në kozmetikë.

Fjalë kyçe: Nanoenkapsulim, Absorbim, Përbërës aktiv, Kozmetikë, Vitamina C, Acid hialuronik.

METODAT ANALITIKE PËR KARAKTERIZIMIN DHE KONTROLLIN E NANOFORMULIMEVE FARMACEUTIKE

Toskë Kryeziu

Qëllimi i Punimit:

Ky studim synon të vlerësojë efikasitetin e metodave analitike në karakterizimin dhe vlerësimin e stabilitetit të medikamenteve të nanoformuluara, me një fokus të veçantë në vajrat esenciale të enkapsuluara në liposome dhe nanoemulsione. Qëllimi kryesor është të identifikojmë dhe të analizojmë efektet antikancer (citotoksik) të këtyre nanoformulimeve në linjat qelizore të ndryshme kanceroze.

Materialet dhe Metodat:

U përdorën vajra esenciale të ndryshëm me origjinë nga Shqipëria, të cilët u enkapsuluan në liposome dhe nanoemulsione përmes metodave të ndryshme nanoformulimi. Karakterizimi i nanoformulimeve u bë përmes teknikave si Zetasizer dhe mikroskopia elektronike (SEM). Stabiliteti i tyre u vlerësua pas 6 muajsh ruajtjeje. Veprimi citotoksik u testua në disa linja qelizore njerëzore (kanceri i gjirit, kanceri i prostatës dhe kanceri kolorektal).

Rezultatet:

Rezultatet treguan se enkapsulimi i vajrave esenciale në nanoformulime përmirëson stabilitetin dhe efikasitetin e tyre. Nanoemulsionet dhe liposomet të përgatitura treguan madhësi dhe stabilitet premtues. Studimet biologjike treguan se nanoformulimet e testuara kishin veprim të favorshëm antikancer në linjat qelizore njerëzore, duke sugjeruar një potencial të lartë për shfrytëzimin e tyre në trajtimin e kancerit.

Përfundimi:

Studimi demonstroi potencialin e metodave analitike për të karakterizuar dhe vlerësuar medikamentet e nanoformuluara, si dhe rëndësinë e nanoformulimeve si strategji për përmirësimin e efikasitetit të vajrave esenciale si agjentë potencial antikancer.

Rezultatet sugjerojnë se nanoenkapsulimi mund të jetë një qasje premtuese për përmirësimin e profileve të sigurisë dhe efikasitetit të vajrave esenciale, duke ofruar një qasje të re për zhvillimin e terapive kundër kancerit.

Fjalët kyçe: Liposome, Nanoemulsion, Nanoteknologji, Analizë dhe kontroll.

FARMAKOTERAPIA E KOLLËS DHE KUJDESI FARMACEUTIK

Fatbardh Plangaj

Kolla është ndër shkaqet më të shpeshta për të cilën pacientët shkojnë për vizitë tek mjeku ose kërkojnë ndihmën e farmacistit. Numri i madh i recetave dhe rasteve me kollë që i drejtohen direkt farmacistit dhe gama e gjerë e barnave, ku shumica janë pa recetë, e bëjnë trajtimin e kollës rastin më të mirë që farmacisti të tregojë rolin e tij, jo vetëm si shpërndarës dhe këshillues i barnave por edhe si këshillues i pacientit, kujdestar i shëndetit të pacientit, edukator dhe promovues i shëndetit të mirë.

Njohja e shkaqeve kryesore të kollës, primive të mjekimit krahas zgjedhjes së alternativës më të mirë të lehtësimit të saj, kur Farmacisti është edhe në rolin e "Bar-Dhënësit" apo "Bar-Përshkruesit" është detyrë profesionale .

Dextromethorphan, Levodropropizina, Bromhexina, Carbocisteina, Ambroxoli edhe pse barna pa recetë kanë kunderindikacione dhe përkujdesje që duhet të njihen dhe të aplikohen nga Farmacisti.

Produktet me bazë bimore ose lëndë të tjera natyrale që përdoren për trajtimin e kollës janë të shumta në numër dhe të larmishme në kombinacione, njohja e përbërjes, efekteve dhe mekanizmave me të cilat ato lehtësojnë kollën përbën një domosdoshmëri për farmacistin. Lëndët ndihmëse që përdoren për pergatitjen e këtyre

barnave dhe produkteve anti-kollë megjithëse të domosdoshme mund të paraqesin problematika për shëndetin dhe gjëndjen shëndetësore të pacientit, ndaj farmacisti duhet që gjithmonë ti njohë dhe ti këshillojë pacientit kujdesin e duhur.

Farmacisti i ka të gjitha aftësitë që të kuptojë një rast me kollë që kërkon vizitë të shpejt tek mjeku sikurse edhe rastin kur Ai vetë mund ti këshillojë pacientit një trajtim disa ditor me synimin e lehtësimit të saj dhe shqetësime të tjera që e shoqërojnë. Farmacisti profesionist me kujdesin që ofron dhe ndjekjen e pacientit mundet që të shmangë keqësimin e gjëndjes apo të një sëmundje bashkëshoqëruese të pacientit .

Farmacisti, si “Edukator dhe Promovues i shëndetit të mirë” në rastin e kollës ka mundësinë për të ndihmuar në luftën ndaj duhan-pirjes dhe për të edukuar popullatën në lidhje me mënyren e ruajtjes së vetes dhe të tjerëve nga përhapja e infeksioneve me anë të spërklave. Terapia e kollës është rasti më i mirë për të treguar dhe kuptuar rolin e plotë të farmacistit në ruajtjen, përmirësimin dhe promovimin e shëndetit të mire për pacientin.

Fjalët kyçe: kolla, ndihma e farmacistit, parimet e mjekimit të kollës

SËMUNDJET KARDIOVASKULARE DHE DISLIPIDEMIA: NJË SFIDË E VAZHDUESHME. ROLI I FARMACISTIT NË MENAXHIMIN E TYRE

Era Goda

Hyrje dhe qëllimi: Sëmundjet kardiovaskulare vazhdojnë të përbëjnë një barrë shëndetësore të rëndësishme globale. Dislipidemitë, veçanërisht nivelet e rritura të LDL-C, luajnë një rol kryesor në zhvillimin dhe përparimin e këtyre patologjive. Arritja e niveleve optimale të LDL-C është thelbësore si për parandalimin parësor dhe dytësor të sëmundjeve kardiovaskulare. Megjithatë, në

një pjesë të konsiderueshme të popullatës nuk arrihen objektivat e rekomanduara, kjo pavarësisht përparimeve në strategjitë dhe udhëzimet terapeutike në përputhje me nivelin e riskut kardiovaskular.

Materiale dhe metoda: Është kryer një hulumtim i detajuar i literaturës në databazat kryesore elektronike si PubMed, Medline, dhe Google Scholar, për artikuj të publikuar në vitet e fundit, duke përdorur terma kërkimi specifike.

Rezultate: Prevalenca e dislipidemive mbetet jashtëzakonisht e lartë. Studimet epidemiologjike tregojnë vazhdimisht se një pjesë e konsiderueshme e individëve, me apo pa sëmundje kardiovaskulare, kanë nivele të pakontrolluara të LDL-C. Kjo thekson hendekun kritik në arritjen e qëllimeve të trajtimit. Farmacistët, si ofrues lehtësisht të aksesueshëm të kujdesit shëndetësor, luajnë një rol qendror në adresimin e kësaj sfide; duke ofruar këshilla mbi modifikimet e stilit të jetesës, aderencën ndaj barnave dhe rëndësinë e monitorimit të rregullt të niveleve të lipideve. Ekspertiza e tyre në klasifikimin e riskut dhe këshillimin e personalizuar, fuqizon pacientët të marrin vendime të mirë-informuara lidhur me shëndetin e tyre kardiovaskular. Përpjekjet bashkëpunuese midis farmacistëve dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor janë thelbësore për të përmirësuar rezultatet në këta pacientë.

Përfundime: Rëndësia e arritjes së niveleve target të LDL-C në menaxhimin e sëmundjeve kardiovaskulare mbetet ende e nënvlerësuar. Përfshirja e rolit të farmacistit është e domosdoshme në ngushtimin e hendekut midis rekomandimeve udhëzuese dhe praktikës aktuale, me qëllim përmirësimin dhe uljen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë kardiovaskulare.

Fjalë kyçe: dislipidemia, sëmundje kardiovaskulare, kujdes farmaceutik, LDL-C

EFEKTI I PROFILAKSISË DEKOLONIZIM-DEKONTAMINUESE KUNDREJTË PROFILAKSISË TRADICIONALE NË KIRURGJINË ORTOPEDIKE NË KOSOVË

Donjeta Ahmetaj

Ky studim synon krahasimin e trajtimit empirik profilaktik me protokolin e profilaksisë dekolonizim-dekontaminim me qëllim të reduktimit të infeksioneve në procedura kirurgjike.

Studimi është realizuar në Spitalin Ortopedik Ortomedica në Kosovë, të dhënat e të gjithë pacientëve të pranuar në spital ndërmjet qershorit 2018 dhe qershorit 2019 janë mbledhur në retrospektivë, të gjithë pacientët e pranuar në spital ndërmjet nëntorit 2021 dhe janarit 2022 janë përcjellur prospektivisht.

127 pacientë u trajtuan në mënyrë empirike dhe 93 pacientë u trajtuan prospektivisht me protokolin e profilaksisë dekolonizim-dekontaminim. Pacientëve të trajtuar në mënyrë empirike iu dha cefazolin para operacionit. Megjithatë, pacientët e trajtuar prospektivisht u testuan fillimisht për infeksionet MRSA dhe infeksionet e vëzhguara u trajtuan me protokol profilaksi dekolonizim-dekontaminim. Statusi i infeksionit dhe vlerat e CRP pas operacionit të pacientëve u krahasuan dhe u gjetën të jenë dukshëm më të larta në grupin empirik (4.7% kundrejt 0, $p = 0.038$ dhe 7.1% kundrejt 0, $p = 0.006$, për grupet empirike dhe respektivisht për grupet dekolonizim-dekontaminim.

Si përfundim, zbatimi i protokolit dekolonizim-dekontaminim është treguar se ulë në mënyrë efektive incidencën e infeksioneve në procedurat kirurgjikale ortopedike. Megjithatë, është e domosdoshme të kryhen kërkime shtesë duke përdorur një mostër më të madhe dhe studime farmakoekonomike, në mënyrë që të vërtetohet qëndrueshmëria e tij si masë profilaktike.

Fjalë kyçe: infeksion i vendit kirurgjik, empirik, dekolonizim, dekontaminim, kirurgji ortopedike

SHËNDETËSIA SI NJË INVESTIM STRATEGJIK, JO NJË BARRË FINANCIARE

Kliti Hoti

Hyrje:

Në këtë punim, prezantohet një perspektivë e re ndaj shëndetësisë si një investim strategjik për të ardhmen e një shoqërie. Përvoja ka treguar se pare si një mundësi për zhvillim dhe përparim shoqëror, shëndetësia mund të jetë një nga përbërësit kryesorë të një strategjie të suksesshme për zhvillimin e qëndrueshëm.

Metodat:

Investimi në shëndetësi shton rritjen ekonomike duke nxitur një forcë pune të shëndetshme dhe duke rritur produktivitetin. Studimet tregojnë një korrelacion pozitiv midis shpenzimeve në shëndetësi dhe treguesve ekonomikë si të ardhurat, GDP, dhe produktivitetit të punës. Investimi proaktiv në shëndetësi përqëndrohet në parandalimin, zvogëlimin e shfaqjes së sëmundjeve dhe minimizimin e terapive të kushtueshme. Investimi në shëndetësi përforcon kërkimin shkencor dhe inovacionin, duke çuar në përparime të mëdha, si dhe siguron zhvillimin e kapitalit njerëzor, duke përmirësuar konkurrencën në nivel global.

Diskutimi:

Shqipëria përballon sfida në qasjen dhe politikat e rimbursimit të barnave, duke çuar në akses të kufizuar të pacientëve në produkte inovative. Edhe pse ka rritje në shpenzimet publike për shëndetësinë si pjesë e GDP, Shqipëria mbetet pas në inovacionin dhe aksesin e barnave krahasuar me vendet fqinje. Megjithatë, ka potencial për përmirësim përmes reformave politike dhe rritjes së investimeve qeveritare në sistemin shëndetësor.

Përfundimet:

Përditësimi i shëndetësisë si një investim ofron përfitime të shumta, duke përfshirë rritjen ekonomike, mirëqenien shoqërore dhe

përparimin kombëtar. Duke e prioritetizuar investimin në shëndetësi dhe duke ndërmarrë reforma politike, Shqipëria mund të përmirësojë aksesin në produkte shëndetësore inovative, të përmirësojë rezultatet shëndetësore dhe të forcojë pozicionin e saj në peisazhin global të shëndetësisë.

Fjale Kyce: Investimi në shëndetësi, parandalimi i sëmundjeve, inovacioni shëndetësor, akses në barna inovative.

DERIVATET E KUMARINËS SI AGJENTË ANTIMETASTATIKË

Lulzime Ballazhi

Kanceri i gjirit është sëmundje malinje e zakonshme që prek një numër të konsiderueshëm femrash në mbarë botën. Potenciali që qelizat të migrojnë ose të rriten në mënyrë invazive, përveç proliferimit, është faktori më i rëndësishëm për zhvillimin e kancerit dhe metastazën e kancerit. Prandaj, për të vlerësuar nëse derivatet e kumarinës ndikojnë në aftësinë e qelizave MCF-7 për të migruar, u krye një test i mbylljes së plagës.

Analiza e migrimit me gërvishtje u krye në qelizat MCF-7. Qelizat MCF-7 u vendosën në 24 pllaka te thella dhe kur ato u rritën në bashkim të plotë, një plagë u shkaktua në qelizat një shtresore duke shkaktuar gërvishtje me një majë mikropipete (100 μ L). Më pas, komponimet e kumarinës në përqendrime të ndryshme (0.01, 0.02, 0.05, 0.1 mmol L⁻¹), vetëm ose me Doxorubicin (1 μ mol L⁻¹), u shtuan menjëherë dhe u mbajtën për 24 orë. U krahasua shpejtësia e mbylljes së plagës së qelizave të trajtuara dhe të patrajtuara.

Fotografitë janë bërë me zmadhim 10 \times duke përdorur mikroskopin e kontrastit fazor (Zeiss Microscopy, Gjermani) menjëherë pas prerjes së plagës dhe në pikat e mëvonshme kohore. Distanca e boshllëkut u vlerësua në mënyrë sasiore duke përdorur softuerin ImageJ (v. 1.48; Wayne Rasband, NIH, SHBA) duke matur zonën e gërvishtjes

në 0 orë dhe 24 orë pas inkubimit. Rezultatet u grumbulluan nga tri eksperimente të pavarura me tri përsëritje për eksperiment. Duke pasur parasysh se shkalla e mbylljes së plagës pasqyron aftësinë migruese të qelizave të kancerit të gjirit, këto rezultate tregojnë se trajtimi me derivate të kumarinës mund të pengojë migrimin e qelizave.

Fjalët kyçe: kanceri i gjirit, migrimi i qelizave, derivatet e kumarinës, doxorubicina

PËRDORIMI DIAGNOSTIKUES I RADIOFARMACEUTIKËVE NË MJEKËSINË NUKLEARE

Sihana A.Lika

Mjekësia nukleare është fushë e mjekësisë e cila përdorë barna radioaktive (shpesh të quajtura "radiofarmaceutikë") për të vlerësuar funksionet dhe proceset metabolike të trupit. Radiofarmaceutikët janë komponentët thelbësorë të mjekësisë nukleare dhe shërbejnë si bazë për imaxhet molekulare duke ofruar mënyra dhe qasje të reja për diagnostikimin dhe trajtimin e hershëm të sëmundjeve.

Radioizotopi më i përdorur në mjekësinë nukleare diagnostikuese është tekneций-99m. Ai mund të lidhet me disa molekula specifike, duke lejuar diagnostikimin e shumë sëmundjeve, përfshirë disa lloje të kancerit. Për shembull, tekneций-99m-MDP (metilen difosfonat) përdoret gjerësisht për të zbuluar metastazat e kockave të lidhura me kancerin. Radiofarmaceutikët përdoren për të prodhuar imazhe të organeve ose indeve, një proces ky i quajtur shintigrafi. Paisja mjekësore e njohur si kamera gama është në gjendje të zbulojë rrezet gama të emetuara nga radioizotopi. Ai gjeneron në mënyrë jo-invasive imazhe që pasqyrojnë funksionin e organit ose indit.

Shintigrafia e njohur gjithashtu si skanim gama është një test diagnostik në mjekësinë nukleare ku radioizotopet e bashkëngjitura

me barnat përkatëse kur kalojnë nga një organ ose ind i caktuar, rrezatimi gama i emetuar kapet nga detektorë të jashtëm (kamera gama) për të formuar imazhe dydimensionale. Skanimi PET/CT është kombinim i skanimit PET (tomografi emituese të pozitronëve) dhe skanimit CT (tomografi e kompjuterizuar). Në skanimin CT përdoren rrezatime me rreze X për të siguruar imazhe të plota të strukturave brenda trupit. Duke kombinuar këto dy teknika, jepen informacione të detajuara tredimensionale duke pasqyruar si anatominë ashtu edhe fiziologjinë e organeve/indeve dhe përcaktohet vendndodhja e saktë e sëmundjes. Me PET/CT mund të identifikohen sëmundjet edhe në fazat e saj më të hershme, përpara ekzaminimeve të tjera imazherike.

Fjalë kyçe: mjekësia nukleare, radiofarmaceutikët, PET, CT, shintigrafia

EKSPOZIMI NDAJ SUBSTANCAVE KANCEROGJENE, MEKANIZMI I VEPRIMIT DHE PREVENTIVA

Drita Yzeiri- Havziu

Në jetën e përditshme ne jemi të rrethuar nga kimikate, të cilat, nga njëra anë, na e lehtësojmë ndjeshëm jetën e përditshme dhe nga ana tjetër, përfaqësojmë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, Ekspozimi i prolonguar dhe frekuent ndaj agjenteve toksik ku një numër i madhë i tyre kontribuojnë në zhvillimin e kancerit dhe janë kategorizuar si iniciatorë ose promotor, në bazë të studimeve kimike të kancerogjenezës. Në këtë punim është rishikuar literatura botrore për klasifikimin e agjentëve gjenotoksik, mekanizmin e veprimit kancerogjenezës dhe preventiva, Agjencioni Ndërkombëtar për Kërkime mbi Kancerin-International Agency for Research on Cancer (IARC) – janë në kërkime e sipër për identifikimin e agjentëve gjenotoksik, monitorimin dhe adresimin e korelacionit në lidhje me sëmundjen e kancerit dhe problematikën e ekspozimit ndaj faktoreve të rezikut me anë të përfshirjes në programet e parandalimit të kancerit. aksesin në shërbimet e shqyrtimit si dhe të diagnostifikimit. Agjentët gjenotoksik klasifikohen në substanca

me prejardhje natyrore, ku bëjnë pjesë: tretësit organikë, metalet e rënda si dhe të gjithë ndotësit e ajrit, epoksidet të cilët përdoren në prodhimtarinë e fijeve të celulozës dhe masave plastike, komponimet organike dhe joorganike të arsenit, kromit, kobaltit, kadmiumit, niklit dhe plumbit, prodhimet farmaceutike, substancat të cilat përdoren si pesticide, rodenticidet, insekticidet komponime organoklore si dhe agjentët gjenotoksik të pranishëm në ujë dhe ushqim, ëmbëlsuesit sintetik, korigjuesit aditivët dhe konzervansët. Rekomandohen programe për vetëdiesimin e populates për konsumimin e ushqimit të shëndetshëm, vitamineve mineraleve, antioksidansëve dhe të ndërmerren masa për të shmangur ekspozimin e panevojshëm ndaj toksinave në mjedisin tuaj.

Fjalë kyçe: Agjentëve gjenotoksik, kancerogjen, preventiva,

PËRDORIMI MJEKËSOR I KANABIS DHE LEGJISLACIONI NË MAQEDONINË E VERIUT

Imer Imeri

Përdorimi mjekësor i kanabisit dhe kanabinoideve i referohet përdorimit të preparateve të kanabisit për kushte të ndryshme mjekësore, me qëllim të pakësimit të simptomave specifike që lidhen me indikacionet e përcaktuara. Produktet me bazë kanabisi mund të përmbajnë substanca të ndryshme aktive dhe mund të administrohen në mënyra të ndryshme. Qasje të ndryshme legalizimi përdoren në vendet Evropiane, me qëllim që preparatet e kanabisit të jenë të disponueshme në treg. Shumë vende të BE-së tani lejojnë pacientët të përdorin droga që përmbajnë kanabinoid dhe preparate me bazë kanabisi nën mjediset specifike. Sipas traktateve ndërkombëtare të kontrollit të drogës, përdorimi i kanabisit në Evropë është i kufizuar për qëllime shkencore dhe mjekësore, të monitoruara nga agjencitë kombëtare përgjegjëse për kontrollin e prodhimit dhe furnizimit të kanabisit për përdorim mjekësor, duke zbatuar korniza të ndryshme rregullatore. Përdorimi i kanabisit për qëllime mjekësore justifikohet vetëm në rastet kur ka dëshmi

të cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të preparateve për gjendjen e paracaktuar mjekësore.

Në fund të vitit 2015, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut nisi një iniciativë për ndryshime legjislative dhe krijoi kushte për përdorimin e kanabisit për qëllime mjekësore. Ai u mbështet nga shumë debate shkencore të zhvilluara nga ekspertë të fushave të ndryshme nga fusha e mjekësisë dhe farmacisë, si dhe nga organizata qytetare. Kjo iniciativë rezultoi me ndryshimet e miratuara në ligjin për kontrollin e substancave narkotike dhe psikotrope, të cilat hynë në fuqi në mars të vitit 2016 dhe rezultuan me legalizimin e kanabisit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37 /16)

Në këtë vit janë miratuar tri udhëzime shtesë që rregullojnë kanabisin dhe produktet me bazë kanabisi për qëllime mjekësore: Udhëzues për formën e recetës, si dhe mënyrën e përshkrimit të produkteve medicinale që përmbajnë substanca dhe bimë të klasifikuara në Listat II dhe III., Udhëzuesi për formularin e aplikimit, dokumentacioni i nevojshëm dhe kriteret e detajuara në lidhje me hapësirën, pajisjet dhe personelin për marrjen e licencës për prodhimin e ekstrakteve të kërpit dhe Vendim për krijimin e Komisionit Shtetëror Ndërministror për Luftën kundër Trafikimit të Paligjshëm, Prodhimit dhe Abuzimit me Drogë.. Me dispozitën e kësaj rregulloreje, ndalimi i preparatit që përmban tetrahidrokanabiol (THC) mund të bëhet nga mjeku i zgjedhur (mjeku i përgjithshëm, specialist i mjekësisë së përgjithshme, specialist i mjekësisë familjare, pediatër me rekomandimin e specialistit të neurokirurgjisë, onkologjisë dhe radiologjisë si dhe sëmundjet infektive, një mjek i punësuar në institucionet shëndetësore publike dhe me aktivitete shëndetësore spitalore. Preparati me bazë kanabidiol (CBD) është i autorizuar si bar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe mund të merret nga pacientët pa rekomandim. Ne rishikojmë përvojën në Republikën e Maqedonisë së Veriut pas legalizimit të kanabisit pa pa dekriminalizim.

Fjalë kyçe: Kanabis, legjislacion, rregullore, preparate me bazë kanabisi.

KOMUNIKIMI DHE DHËNIA E PLOTË E UDHËZIMEVE PROFESIONALE PËRBËJNË SHTYLLËN KRYESORE TË USHTRIMIT TË PROFESIONIT NË BARNATORE

Zehadin Gashi

Komunikimi profesional është një proces i cili zhvillohet në mes të farmacistit dhe pacientit. Përbëhet nga komunikimi jo verbal dhe verbal. Është shumë i rëndësishëm, sepse përfshin mbi 70% të kohës së punës në barnatore. Komunikimi në barnatore bëhet me qëllim që, me anë të udhëzimeve që jepen, pacientit t'i mundësojë krijimin e besueshmërisë në përdorimin e drejt dhe të sigurt të barnave. Dhënia e udhëzimeve për barna duhet të jetë e plotë, e shkurtër dhe e kuptueshme për nivelin e pacientit.

Qëllimi i këtij prezantimi është që të njihemi me rëndësinë e komunikimit dhe dhënien e udhëzimeve të plota për barna. Metoda e punës është bazuar në komunikimin me personelin në barnatore dhe kërkesat për të dhënë udhëzime të caktuara lidhur me përdorimit të barnave. Për këtë qëllim objekt i hulumtimit kanë qenë mbi 300 barnatore, ku është përcjell mënyra e komunikimit dhe janë kërkuar sqarime lidhur me përdorimin e barna.

Bazuar në analizën e bërë, mund të themi se është shqetësuese mënyra se si komunikohet dhe si jepen udhëzimet për barna. Në aspektin e komunikimit jo verbal janë vërejtur mosmbajtja e mantilit, përdorimi i telefonit etj., ndërsa komunikimi verbal ka qenë i shkurtër, në të shumtën e rasteve i shprehur me numra dhe pa sqarime të duhura lidhur me përdorimin dhe kujdesin gjatë përdorimit.

Nga faktorët e identifikuar ka qenë mos prezenca e farmacistit në barnatore, ku në vend të tij kanë qenë prezentë personeli jo kompetent, pamundësia për t'u përgjigjur pyetjeve të parashtruar, si pasojë e moskryerjes së praktikës profesionale dhe mungesës së trajnimeve të nevojshme lidhur me ushtrimin e pavarur të profesionit në barnatore.

Rekomandojmë që institucionet përkatëse të ndryshojnë mënyrën e licencimit të barnatoreve e cila bëhet me një farmacist përgjegjës dhe një teknik. Oda e Farmacistëve të merr nën mbikëqyrje kryerjen e praktikës profesionale para se farmacistët t'i nënshtrohen provimit profesional, sepse tani lëshohen vetëm vërtetime formale. Gjithashtu OFK-ja të organizojë seminare dhe trajnime lidhur me organizimin dhe punën në barnatore, duke sjellë përvoja të reja të ushtrimit të profesionit në barnatore.

Fjalë kyçe: komunikim, udhëzim, barnatore

Seanca Plenare 2: ROLI I FARMACISTIUT NË SISTEMIN SHËNDETËSOR DHE VIZIONI PËR TË ARDHMEN

NJOHJA E SIMPTOMAVE TË RREZIKSHME NË BARNATORE

Laureta Berisha Kosumi

Qëllimi

Janë të përditshme rastet e kërkesave të ndryshme nga pacientët që qasen në barnatoret komunitare për t'ju ofruar zgjidhje të shpejta rreth gjendjeve të ndryshme mjekësore, përfshirë edhe simptomat e rrezikshme, të cilat në pamje të parë mund të duken lehtë të zgjidhshme, por në fakt janë simptoma të cilat duhet trajtuar si emergjenca mjekësore duke i udhëzuar direkt te mjeku përkatës. Qëllimi im i trajtimit të kësaj teme është i mveshur me shqetësimin e ruajtjes së shëndetit të pacientit nga këto simptoma të cilat na duken të zgjidhshme nga dituria jonë si farmacistë, por në fakt duhet trajtim i mënjehershëm nga ana e mjekut. Shtuar kësaj, mundësinë e gabimeve të shumta që mund të ndodhin nga prezenca e personave jo kompetent në barnatore, me qëllimin e parë të zgjidhjes së problemit dhe idesë së gabuar që patjetër ti shitet diçka pacientit.

Materialet dhe metodat

Farmacistët të edukohen përmes ndjekjes së trajnimeve dhe seminareve të ndryshme për ti njohur simptomat e rrezikshme dhe

të përgatiten për situata emergjente, duke e vënë në fokus ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të pacientit. Të përdoren protokolle standarde për konsultim me pacientët rreth simptomave të rrezikshme, si dhe të monitorohen këto simptoma. Poashtu, të përdoren udhëzime të qarta që ti referojmë pacientët te mjeku, atëherë kur simptomat janë të rrezikshme apo të komplikuar, gjithmonë duke e ruajtur qetësinë dhe duke mos e shqetësuar pacientin. E në fund ura lidhëse farmacist- mjek, duhet të jetë hallkë e fortë profesionale, për të siguruar trajtimin e duhur për pacientët me simptoma të rrezikshme, duke çmuar dhe vlerësuar punën e njëri tjetrit, gjithmonë në të mirë të shëndetit të pacientit.

Rezultatet e punimit

Si rezultate të këtij punimi do të theksin në marrjen e njohurive nga farmacistët, e sidomos farmacistët e rinjë, rreth identifikimit të simptomave të rrezikshme, duke përfshirë një listë të simptomave të rrezikshme që mund të vijnë në kontakt me farmacistët në barnatore.

Simptoma të tilla mund të jenë: vjellja, infeksionet mikotike, temperatura e lartë, shenjat e një ataku akut kardiak; e shumë të tjera që do të i vë përgjatë prezantimit.

Këtë punim do të plotësoj me shembuj praktik, në të cilët njohja e simptomave të rrezikshme ka pasur një impakt të lartë pozitiv në kujdesin për pacientët në barnatore.

Përdorimi i studimeve shkencore, literaturës së specializuar dhe udhëzimeve profesionale, qon në mbështetje dhe përmirësimin e njohurive rreth simptomave të rrezikshme në barnatore, e më pas nga këto njohuri të aftësohen edhe farmacistët të rinjë dhe këso forme të ndërtohen hallka të rëndësishme në ruajtjen e shëndetit të pacientit, duke i ofruar zgjidhjen më profesionale.

Përfundimi: Në përfundim do të theksohen përfitimet për farmacistët dhe pacientët në njohjen e këtyre simptomave të rrezikshme. Për farmacistët, kjo njohje do të rrisë kapacitetin e tyre për të ofruar këshilla dhe ndihmë të menjëhershme në rastet kur simptomat janë të rëndësishme dhe kërkojnë ndërhyrje të shpejtë. Kjo gjithashtu mund të përmirësojë reputacionin e barnatoreve si qendra të sigurta dhe të besueshme për kujdesin shëndetësor e jo vetëm për shitje të barnave.

Në anën tjetër, për pacientët, njohja e simptomave të rrezikshme do të rrisë vetëdijen e tyre për shëndetin dhe do t'i ndihmojë ata të kërkojnë ndihmë mjekësore në kohë sa më të shpejtë dhe të shmangin komplikime të mundshme shëndetësore.

INOVACIONI DHE AKSESI NDAJ TRAJTIMEVE TE REJA

Marinela Dibra

Qëllimi:

Në momentin që një person bëhet pacient, bota e tij ndryshon. Kërkimi përmes R&D dhe qasjeve të reja të aksesit, që të lehtësojmë sëmundjet me barrën më të madhe. 50% e miratimeve të reja nga EMA dhe FDA në 2022 ishin barna biologjike, 148 terapi gjenetike dhe qelizore që nga viti 2019, 200 të tjera pritjet deri në vitin 2026. Sa nga këto janë të aksesueshëm në Kosovë, Shqipëri?

Përshkrimi:

Sëmundjet Kardiovaskulare dhe onkologjike janë shkaku kryesor i vdekjeve në botë. Numri më i lartë i vdekjeve dhe i invalidizimit është në vendet me të ardhura të ulta dhe të mesme të EU. Sipas të dhënave të OBSH1 17.92 milion vdekje nga SKV u raportuan në 20152, në Onkologji u raportuan rreth 9.0 milion1 vdekje, 1,6 milion nga Diabeti1. Nevojat janë në rritje për rregjistrimin dhe trajtimin me barna të reja si frenues të PCSK-9 (si-RNA), CVRR-Lp(a), mCRPC, frenues të CDK4/6, CAR-T në imunologji etj

Rezultatet dhe përfundimi:

“WHO 25x25 - Global Action Plan”, thekson nevojat urgjente për të adresuar vdekshmërinë dhe nevojën për të reduktuar me 25% deri në 20253. 1 nga 3 adultë vuan me sëmundshmëri kronike, të cilët kanë nevojë për 6-8 mjekime në ditë. Dhe vetëm 50% e pacientëve e arrijnë mjekimin në kohë4. Sipas të dhënave të IQVIA5 aksesit ndaj terapive të reja arrin 562 ditë, shkalla e disponueshmërisë është 5% në Shqipëri dhe Kosovë. Pra, ka një distance kohore ndërmjet terapive të reja dhe aksesit ndaj trajtimit, distance kohore ndërmjet strategjisë OBSH globale dhe asaj lokale.

ANALIZA E PËRDORIMIT TË BARNAVE PA RECETË TE PACIENTËT QË VIJNË NË VIZITA MJEKËSORE

Fitim Gashi

Bazuar në mundësinë e marrjes së barnave pa recetë, shumica e pacientëve për probleme të ndryshme shëndetësore së pari drejtohen në barnatore, pa u vizituar te mjeku. Simptomat dhe problemet shëndetësore që ata kanë, kryesisht janë me dhimbje koke, pagjumësi, temperaturë, plogështi etj. Barnat më të shpeshta që marrin janë analgjetikët, antipiretikët, anksiolitikët etj. Qëllimi i këtij punimi është që të analizojmë përdorimin e barnave pa u vizituar te mjeku dhe pasojat të cilat mund të jenë nga përdorimi tyre i gabuar.

Metoda e hulumtimit është bazuar në pyetjen e pacientëve në ordianca para se me i përshkruar barnat lidhur me përdorimin e mundshëm të ndonjë bari dhe para se me u vizitua te mjeku. Rezultate flasin se një pjesë e pacientëve që kanë përdorur barna për dhimbje koke, si për shembull analgjetikët, për pasojë kanë qenë me tension të gjakut ose lipidemi. Një pjesë e tyre kanë përdorë antibiotikë te rastet virale me grip e kështu me radhë.

Marrja e këtyre barnave pa u diagnostifikuar nga mjeku ka rezultuar në 6 raste me probleme të tensionit të lartë, 2 me lipidemi, 17 raste me antibiotikë te sëmundjet virale e kështu me radhë. Si konkluzion mund të themi se marrja e barnave pa recetë është një shprehje e përditshme e cila mund të ketë pasoja të rënda, sepse fshehin shkaktarin e vërtetë të sëmundjes, duke shkaktuar pasoja të rënda, siç mund të jenë sulmet në tru dhe zemër, krijimin e rezistencës mikrobike te antibiotikët, varshmërinë te barnat që veprojnë në sistemin nervor etj.

Rekomandojmë që në barnatore dhënia e analgjetikëve për dhimbje koke, së paku të bëhet nën monitorimin e shtypjes së gjakut, matjen e nivelit të yndyrnave, pastaj dhënia e antibiotikëve të cilët gjithnjë e më shumë po tregojnë rezistencën antimikrobike, barnat si:

diazepam, bromazepam etj., të cilët shkaktojnë varshmëri etj., të mos të jepen pa recetë.

Fjalë kyçe: barna, recetë, vizita mjekësore

NDIKIMI I PROMOCIONIT NË KËRKESËN PËR BARNË PA RECETË DHE ROLI I FARMACISTIT NË PËRDORIM TË SIGURT DHE EFEKTIV TË TYRE

Granit G. Çeku

Hyrje dhe qëllimi. Promocioni si funksion komunikues i marketingut është një çështje me rëndësi dhe interes në zhvillimin e aktivitetit në ndërmarrjet farmaceutike. Promocioni është një faktor i rëndësishëm në organizimin e shitjes së produkteve farmaceutike dhe për të qenë konkurrent në treg. Qëllim i punimit është të shikohet ndërlidhja e kërkesës me reklamimin e barnave që merren pa recetë e poashtu edhe roli i farmacistit në përdorimin e sigurt dhe efektiv të tyre. Ky punim do t'i japë përgjigje pyetjes kërkimore: A ka ndikim promocioni në kërkesën për barna pa recetë (OTC barna)?

Materiale e metoda. Për realizimin e këtij punimi është përdorur një metodologji që konsiston në një kombinim të të dhënave primare me ato sekondare. Ky studim u zhvillua mbi bazë pyetësorësh dhe intervistave, realizuar në qyteteve të ndryshme në Kosovë, në një mostër prej 100 individëve. Pastaj të dhënat e mbledhura janë sistemuar dhe përpunuar në programin SPSS, dhe janë nxjerrë rezultatet e kërkuara.

Rezultate. Ne mund të pohojmë se kërkesa e barnave pa recetë është e lidhur në masë të caktuar sa i përket reklamave. Sa i përket pyetjes kërkimore, nga të dhënat e mbledhura për pyetjen kërkimore, interpretimi do të ishte ky: nëse e marrim në tërësi shohim se promocioni ka ndikim pozitiv në kërkesën për barnat pa recetë.

Përfundime. Bazuar në rezultatet e punimit, e që kanë të bëjnë më ndikimin e promocionit në rritjen e shitjes së produkteve farmaceutike që jepen pa recetë, kemi gjetur se promocioni ka ndikim në shitjen e produkteve farmaceutike të tilla. Rekomandojmë

që për barnat që jepen pa recetë, aktivitetet promovionale të jenë prezentë e sidomos të kenë njohuri mjekët, farmacistët e pacientët, por që të arsyetohet nevoja e përdorimit të tyre, dhe të merren këshillat e nevojshme nga profesionistët shëndetësorë, sepse edhe për barnat pa recetë, roli i tyre në përdorim të sigurt dhe efektiv të barnave është i jashtëzakonshëm.

Fjalë kyçe: Barna pa recetë, farmaceutike, promovioni.

ASCVD, SIRNA DHE INHIBIMI I PCSK9, NJË EPOKË E RE NË MENAXHIMIN E KOLESTEROLIT

Orgesa Dino

Hyrje:

Sëmundja aterosklerotike kardiovaskulare (ASCVD) është ende shkaku kryesor i vdekjeve në mbarë botën. Pavarësisht qasjeve të shkëlqyera farmakologjike, evidencat tregojnë vazhdimisht se shumë njerëz me dislipidemi nuk arrijnë menaxhimin optimal dhe shumë prej tyre trajtohen me terapi hipolipemiante me intensitet të ulët. Përtej lidhjes së mirënjohur midis LDL-C dhe parandalimit kardiovaskular, aterogjeniteti i lipoproteinës (a) dhe ndikimi i lipoproteinave të pasura me trigliceride (TG) nuk mund të anashkalohet. Në këtë kuader, përdorimi i terapive të bazuara në ARN mund të ndihmojë në trajtimin e çrregullimeve të lipideve, kur vlerat target janë të vështira për t'u arritur.

Zhvillimi:

Qëllimi i terapive që reduktojnë nivelet e LDL-C është të arrihet në mënyrë të sigurtë një reduktim i qëndrueshëm dhe afatgjatë i ekspozimit të enëve të gjakut ndaj lipoproteinave aterogjene, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i sëmundjeve aterosklerotike kardiovaskulare (ASCVD) dhe ngjarjeve kardiovaskulare bashkëshoqëruese, si infarktët e miokardit dhe goditjet ishemike. Një molekulë e re që ul në mënyrë efikase LDL-C është Inclisran, një ARN e vogël sintetike interferuese, që targeton PCSK9 (proteina konvertazë subtilisin/kexin tip 9). Grupi i studimeve Orion ka treguar

se terapia siRNA që synon PCSK9, e aplikuar në rrugë subkutane dy herë në vit, ul në mënyrë afatgjatë dhe efikase LDL-C me afërsisht 50% dhe është e sigurtë dhe e mirëtoleruar.

Konkluzione:

Në epokën kur po shkohet drejt menaxhimit të personalizuar të riskut, përdorimi i siRNA përfaqëson një epokë në lulëzim në trajtimin e dislipidemive për reduktimin e riskut të ASCVD.

Fjalë kyçe: ASCVD, siRNA, LDL-C, PCSK9

AVANCIMET NË MENAXHIMIN TERAPEUTIK TË INSUFICIENCËS KARDIAKE

Ervin Lavdari

Hyrje:

Insuficiencia Kardiake është një gjendje klinike që karakterizohet nga një vdekshmëri dhe sëmundshmëri e lartë e që ndodh kur zemra nuk është në gjendje të pompojë mjaftueshëm gjak për të përmbushur kërkesat metabolike të organizmmit. Menaxhimi farmakologjik i Insuficiences Kardiake është revolucionarizuar gjatë dekadës së fundit me trajtime të reja farmakologjike.

Zhvillimi:

Ndër përparimet e fundit farmakologjike që i shtohen armatës së terapive në përdorim të udhëzuara nga udhëzuesit ndërkombëtarë të Shoqatës Evropiane të Kardiologjisë (ARNI/ ACEi, Beta Bllokuesit, Antagonistët e Receptorëve Mineralkortikoidë, SGLT2i etj), mund të përmendim edhe finerenone, omecamtiv mecarbil, vericiguat dhe Hekur Carboxymaltose. Barnat e sipërpermendura janë treguar se reduktojnë hospitalizimet prej Insuficiencës Kardiake. Megjithatë, mes tyre vetëm SGLT2i, vericiguat dhe omecamtiv mecarbil kanë treguar se reduktojnë vdekjen për shkaqe kardiovaskulare, ndërkaq finerenone është treguar se zvogëlon ngjarjet kardiovaskulare dhe efektet anësore renale në pacientët me diabet dhe sëmundje renale kronike.

Trajtimi i linjës së parë të pacientëve me IK me fraksion të ejsionit të reduktuar përfshin terapi themelore me frenues të receptorit të angiotenzinës-neprilizinës ARNI/ ACE-inhibitorët/ ARB, bllokuesit, antagonistët e receptorëve mineralokortikoidë, inhibitorët e co-tranpostuesit të natrium-glukozës-2 dhe diuretikët. Trajtimi i linjës së parë të pacientëve me IK me fraksion ejsioni lehtësisht të reduktuar ose me fraksion ejsioni të ruajtur përfshin frenuesit e SGLT2 dhe diuretikët.

Konkluzione: Terapia aktuale e katërfishtë në trajtimin e Insuficiencës Kardiake (ARNI, Beta Bllokues, MRA dhe SGLT2i) ka demonstruar një reduktim të hospitalizimeve të pacientëve dhe një ulje sinjifikative të mortalitetit. Hulumtimet e terapive individuale të Insuficiencës Kardiake kanë treguar përfitime në shumë pacientë me IK. Studimet e mwtejshme mbi terapitë e reja do të ndihmojnë në përmirësimin e rezultateve të pacientëve me Insuficiencë Kardiake.

Fjalë kyce: Insuficiencë Kardiake, ARNI, SGLT2i

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KUADRIT RREGULLATOR TË PRODUKTEVE MJEKËSORE TË TERAPISË SË AVANCUAR NË EUROPË

Angjelina Koço

Prezantimi paraqet një pasqyrë të gjerë të rregullimit të Produkteve Mjekësore të Terapisë së Avancuar në Europë. Pikat kyce janë Agjencia Europiane e Barnave (EMA) është përgjegjëse për rregullimin e barnave, duke përfshirë PMTA në Europë. PMTA klasifikohen në tri kategori: terapia e gjeneve, terapitë e qelizave somatike dhe produktet e ingjineritit të indeve. Këto terapi janë rregulluar sikurse barnat në BE, përkundër transplanteve të qelizave/ indeve substancialisht të manipuluar.

PMTA kanë disa karakteristika unike në krahasim me barnat tradicionale me molekula të vogla, sikurse administrimi i njëhershëm, prodhimi kompleks dhe vështirësitë në kthimin e efekteve. Rregullimi i PMTA ne Europë përfshinë procedurën e centralizuar në EMA, të përcjellur nga vendimet në nivel vendi për qasjen e pacientit.



Prezantimi reflekton sfidat kyçe në zhvillimin e PMTA, duke përfshirë definimin e produktit, sigurimin e efikasitetit afatgjatë dhe gjenerimin e provave reale. Rregullatorët ofrojnë vegla të ndryshme për mbështetje të zhvilluesve të PMTA, sikurse këshilla, klasifikim dhe certifikim.

Strategjia Shkencore Rregullatore e EMAs deri 2025 thekson prioritetet për rregullimin e PMTA, duke përfshirë boshllëkun ndërmjet vlerësimit dhe qasjes së pacientit, angazhimin me akterë të ndryshëm dhe promovimin e përdorimit të të dhënave reale.

Prezantimi thekson rëndësinë e dialogut të hershëm dhe të vazhdueshëm ndërmjet rregullatorëve, zhvilluesve dhe akterëve tjerë përmes këshillave të natyrës shkencore, këshillave paralele me FDA dhe kualifikimin e metodologjive të reja. Angazhimi me zhvilluesit akademik dhe jo-fitimprurës është poashtu një fushë kyçe për EMAn. Në fund, prezantimi ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjendjes së rregullimit të PMTA në Europë, dhe strategjive të përdorura nga EMA për të adresuar sfidat unike të këtyre terapive inovative si dhe disa konsiderata për mënyrën se si mund të kontribuojmë në baza lokale në përcaktimin e rregullimit dhe zhvillimin e dialogut të përshtatshëm për të mundësuar qasjen e pacientëve dhe përfshirjen e këtyre terapive inovative në praktikën tonë lokale klinike.

Fjalët kyçe: Produktet mjekësore të terapisë së avancuar, gjendja e rregullimit, sfidat, EMA, terapia me gjene.

MENAXHIMI I PACIENTËVE ME LEUKEMI KRONIKE MIELOIDE (CML): PRAKTIKAT BASHKËKOHORE DHE QASJET INOVATIVE

Fjolla Buçinca

Leukemia Kronike Mieloide (CML) është një sëmundje hematologjike që karakterizohet nga prania e kromozomit Filadelfia dhe prodhimi i tepërt i qelizave të bardha të gjakut. Përparimet e fundit në terapinë e synuar kanë ndryshuar ndjeshëm perspektivën e trajtimit për pacientët me CML.



Qëllimi kryesor i punimit: Ky punim paraqet një përmbledhje të praktikave më të mira në menaxhimin e pacientëve me CML, duke u fokusuar në përdorimin e terapive të synuara, monitorimin e përgjigjes ndaj trajtimit, dhe strategjitë për menaxhimin e efekteve anësore.

Metdologjia: Terapia me tirozin-kinaza inhibitorë (TKI) ka revolucionarizuar trajtimin e CML, duke u ofruar pacientëve një opsion jo-invaziv që mund të kontrollojë sëmundjen në mënyrë efektive. TKI-të, kanë treguar përfitime të konsiderueshme në uljen e qelizave anormale dhe përmirësimin e mbijetesës së pacientëve.

Rezultatet: Monitorimi i rregullt i përgjigjes ndaj trajtimit është kritik për menaxhimin e suksesshëm të CML. Testimi i peshës molekulare dhe analizat e tjera të gjakut lejojnë mjekët të përcaktojnë efikasitetin e terapisë dhe të marrin vendime të informuara mbi vazhdimësinë ose ndryshimet e trajtimit. Për më tepër, menaxhimi i efekteve anësore të mundshme, të tilla si toksiciteti kardiovaskular ose toksiciteti hepatic, është thelbësor për të siguruar që pacientët të mund të përballojnë trajtimin afatgjatë.

Ky punim do të diskutojë gjithashtu sfidat dhe përparimet e reja në menaxhimin e CML, duke përfshirë zhvillimin e terapive të reja dhe mundësitë për përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve.

Përfundime: Duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërdisiplinor dhe edukimit të vazhdueshëm të farmacistëve, qëllimi është të nxisë praktikat më të mira për menaxhimin e pacientëve me CML në Kosovë dhe rajone të tjera.

Fjalë kyçe: Leukemia, Kronike, Mieloide, Filadelfia, Terapi, Kosovë.

EVIDENTIMI I LËNDËVE NDIHMËSE TË DËMSHME NË PËRGATESAT PEDIATRIKE SHURUPE QË JANË NË REGJISTRIN E BARNAVE 2024

Enxhi Vocagodo

Formulimet farmaceutike në ditët e sotme janë jashtëzakonisht të larmishme, si për administrim intra-venoz, intra-nazal deri te ai oral, ndër më të pëlqyerit për shumicën e grupmohave. Falë eksipientëve, të cilët së pari i sigurojnë barit qëndrueshmëri dhe efikasitet veprimi, së dyti mbulojnë aspektin e performimit të barit në nivel shqisor. Maskimi i shijes dhe aromës, veçanërisht në formulimet pediatrike orale për të siguron konsumimin pa problem nga fëmijët, që rrjedhimisht garanton suksesin terapeutik tek kjo kategori pacientësh të vegjël. Eksipientë që përdoren në formulimet e të rriturve jo domosdoshmërisht janë po aq të sigurtë kur përdoren në raste pediatrike, edhe në përqëndrime shumë të ulta. Siguria e këtyre përbërësve zakonisht aprovohet duke u bazuar në studime afate të ndryshme kohore në popullatën e rritur, por jo në atë pediatrike. Për këtë arsye, ata s'mund të jenë gjithmonë të përshtatshëm, nga ndikimi negativ që mund të kenë në shëndetin e fëmijëve. Synimi i këtij studimi është evidentimi i barnave pediatrikë, konkretisht formë shurupesh, në Republikën e Shqipërisë, me lëndë ndihmëse toksike (sipas llojit dhe formë-dozës) për moshat pediatrike.

Nga njëra anë, përshkruhen eksipientët më të përdorur në formulimet shurupë të popullatës pediatrike, duke krahasuar lëndët ndihmëse që literatura shkencore i ka cilësuar si potencialisht të dëmshme, sipas efekteve anësore që krijojnë pas ekspozimit. Nga ana tjetër vë në dukje rëndësinë e kryerjes së kontrolleve të sigurisë dhe cilësisë tek eksipientët, për minimizim të çdo veprimi të dëmshëm te fëmijët.

Përcaktimi i dozës maksimale ditore të lejuar lënde ndihmëse, vlerësimi i efekteve të padëshirueshme te pacientët pediatrik nga autoritetet shëndetsore, duke mos lënë jashtë fokusit risi në formulime eksipientësh, rrisin standartin dhe besueshmërinë në mjekimin përkatës.

Fjalët Kyçe: Formulime, Shurup, Eksipient, Efekte anësore, Toksicitet, Pediatri, Kontroll cilësie

FUQIA E DRITES: METODAT OPTIKE NE HULUMTIMET BAZIKE PER KARAKTERIZIMIN E RECEPTOREVE TARGET DHE PROCESI I ZHVILLIMIT TE BARNAVE

Taulant Kukaj

Metodat optike janë thelbësore në hulumtimet bazë për vëzhgimin e targeteve dhe receptorëve në nivel molekular. Teknika të tilla si mikroskopia fluoeshente, mikroskopia konfokale dhe mikroskopia me super-rezolucion mundësojnë vizualizimin e dinamikës së targetit dhe receptorit në qelizat dhe indet e gjalla. Këto metoda ofrojnë imazhe me rezolucion të lartë, duke i lejuar hulumtuesit të studiojnë lokalizimin, trafikimin dhe ndërveprimet e targeteve dhe receptorëve, duke rritur njohuritë tona për rolet e tyre në proceset qelizore dhe mekanizmat e sëmundjes. Duke kombinuar metodat optike me teknikat e avancuara të etiketimit dhe analizën sasiore të imazhit, studiuesit mund të nxjerrin informata të vlefshme për dinamikën e targetit/receptorit, duke avancuar kështu njohuritë tona për proceset bazë biologjike dhe duke lehtësuar zbulimin dhe zhvillimin e barnave.

Receptorët e bashkuar me proteinën G (GPCRs) janë proteina thelbësore të membranës me funksione të rëndësishme fiziologjike dhe patofiziologjike në trupin e njeriut. Përafërsisht 30-50% e barnave në treg synojnë GPCR-të. Metodat optike luajnë një rol kryesor në përmirësimin e të kuptuarit dhe karakterizimit të këtyre barnave. Studimi ynë fokusohet në receptorët metabotropikë të glutamatit

(mGluRs), një nëngrup i GPCR-ve të rëndësishëm për plasticitetin sinaptik, të mësuarit dhe kujtesën. Ne përdorëm Transferimin e Energjisë së Rezonancës Fluoreshence (FRET) për të hetuar mekanizmin e aktivizimit, kinetikën dhe dimerizimin e mGluRs.

Ne zhvilluam sensorë mGluR FRET duke inkorporuar proteina fluoeshente në monomeret përkatëse, i shprehëm këto konstruksione në *Xenopus laevis* oocite dhe monitoruam aktivizimin duke përdorur fluorometri konfokale patch clamp -outside out.

Gjetjet tona tregojnë se aktivizimi i mGluR ndodh në mënyrë sequenciale në dy hapa të veçantë brenda kornizës kohore milisekondëshe. Për më tepër, ne kemi vërejtur se mGluRs mund të formojnë heterodimerë brenda grupeve të ndryshme mGluR.

Ky zbulim ka potencialin për të sqaruar dinamikën komplekse që qëndron në themel të proceseve të plasticitetit sinaptik, të mësuarit dhe kujtesës.

Fjalët kyce: Receptorët e bashkuar me proteinën G (GPCRs), Transferimi i Energjisë së Rezonancës Fluoreshence (FRET), Receptorët Metabotropikë të Glutamatit (mGluRs), Fluorometria konfokale patch clamp

EFIKASITETI I PREPARATIVE KOZMETIKE NE TRAJTIMIN E ACNE VULGARIS

Nexhibe Nuhi

Acne vulgaris është çrregullim i shpeshtë i lekurës që paraqitet tek adoloeshentët dhe është mjaft shqetësuese për ato. Qëllimi i studimit tonë ishte që të shiqojme sa janë te vetëdijshëm adoloeshentët në trajtimin e akneve .Duke u bazuar ne faktin se preparatet kozmetike dhe makijazhet e ndryshme i mbulojnë apo i maskojnë ato, në anketimin e bërë verejme se 55% e adoloeshentëve perdorin preparate kozmetike pa udhëzimin e dermatologut dhe si rezultat kemi

përkeqsimin e akneve tek të cilët pastaj janë paraqitur inflamacione. 25% e adoleshentëve kanë përdorur preparate kozmetike bashkë me ato dermatologjike duke filluar nga larësit e kështu me radhë, sipas udhëzimeve të dermatologut të cilët kanë pas përmirësime të dukshme .

20% e adoleshentëve kanë përdorur preparate kozmetike të orientuara nga kosmetisti ku efikasiteti i tyre në fillim ka qenë mesatarisht i mirë por kostoja e tyre shumë e larte.

Sipas rezultateteve të anketimit mund të konkludojmë se për çdo ndryshim duhet patjetër të lajmërohen tek dermatologu dhe njëkohësisht tu përmbahen udhëzimeve të dermatologut sepse një trajtim jo adekuat është faktor potencial për përkeqësimin e akneve por edhe len shenja në lëkurë. Sepse përdorimi i preparateve kozmetike në mënyrë të duhur jep efikasitet.

Fjalët kyçe: acne vulgaris, adoleshentët, ekspozimi kozmetik.

ANALIZA ORTOGONALE E GLIKOPROTEINAVE KOMPLEKSE: VLERËSIMI I KUALITETIT DHE HETEROGJENITETIT TË FORMULIMEVE ME GONADOTROPINA

Liridon Muçaku

Hyrje: Bioteknologjia farmaceutike kërkon analiza rigoroze, duke përdorur metoda të ndryshme për karakterizimin e plotë. Teknikat elektroforetike janë të vlefshme për analizimin e molekulave me masë të lartë molekulare, veçanërisht glikoproteinave komplekse, duke vlerësuar heterogjenitetin dhe madhësinë e tyre. Ndërkohë, spektrometria e masës siguron përcaktimin e saktë të masës molekulare të molekulave të paprekura, pavarësisht nga madhësia ose forma e molekulës. Studimi synonte të vlerësonte cilësinë e bioterapeutikëve dhe të adresonte sfidat e përcaktimit të masës molekulare duke përdorur metodologji ortogonale.

Materialet dhe metodat: Gjashtë biologjikë të ndryshëm të disponueshëm në treg, të përbërë nga gonadotropina me origjinë njerëzore dhe rekombinante, u studiuan duke përdorur elektroforezë xhel dhe elektroforezë kapilare me mikroçip dhe MALDI-TOF-MS. Lëshimi enzimatik i glikanit u krye për të hetuar ndikimin e masës së glikanit në kompleksitetin dhe përcaktimin e saktë të masës molekulare të gonadotropinave në studim.

Rezultatet: U demonstrua kompleksitet i lartë dhe makro- dhe mikroheterogjenitet ekstrem, tipik për glikoproteinat. Në elektroforezën e xhelit, bioterapia tregoi një sjellje tipike, me shumë breza dhe modele komplekse pikash që migronin në z dhe pI të ndryshëm, ndërsa në elektroforezën kapilare me mikroçip u përfatuan maja të gjera në diapazonin e lartë të masës për shkak të efektit të glikanit. Këto efekte ishin të qëndrueshme në glikoproteina të ndryshme me përbërje të ndryshme glikane. Pas çlirimit të oligosakaridit, u përfatuan maja më të ngushta dhe në intervale më të ulëta të masës, që korrespondojnë me masën reale molekulare. Megjithatë, MALDI-TOF/MS mundësoi përcaktimin e saktë të masës molekulare të biomolekulave të paprekura.

Përfundime: Gonadotropinat shfaqën heterogjenitet të konsiderueshëm, me sjellje migrimi elektroforetike tipike për biologjikët. Kjo qasje ortogonale rezultoi të jetë e aftë për përcaktimin e saktë të masës molekulare dhe pastërtinë dhe integritetin strukturor të biologjive komplekse si gonadotropinat.

Fjalë kyçe: biofarmaceutikë, glikoproteina, metodologji ortogonale, spektrometri e masës.

MARRËVESHJE DHE NEGOCIME PËR BARNAT TË RIMBURSUARA

Alida Sino

Qëllimi i punimit: Marrëveshjet konfidenciale të rimbursimit aplikohen nga shumë shtete për të reduktuar shpenzimet në buxhet dhe për të përmisuar përdorimin e barnave të reja. Gjatë viteve të fundit, në Shqipëri kanë hyrë në fuqi ndryshime ligjore që parashikojnë negociimin e çmimeve të barnave dhe lidhjen e marrëveshjeve me mbajtësit e autorizimit për tregtim. Qëllimi i këtij punimi është që në kuadër të ndryshimeve ligjore të përshkruajë llojet dhe zbatimin e marrëveshjeve për reduktimin e çmimit të barnave të rimbursuara.

Materiale e metoda: Të dhënat për barnat u morën nga databaza e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. U realizua analizë e të dhënave, mbi zbatimin e marrëveshjeve për reduktimin e çmimit të barnave të rimbursuara, gjatë viteve 2018-2023, në Shqipëri.

Rezultate: Nga barnat e rimbursuara me marrëveshje, dominojnë në numër, barnat spitalore kundrejt barnave të rrjetit të hapur (76% kundrejt 24%). Marrëveshjet janë lidhur për barna të rimbursuara, ekzistuese dhe barna të reja inovatore. Vlerën më të lartë të rimbursimit e kanë barnat që i përkasin nëngrupit terapeutik L01- (Antineoplazikët), sipas klasifikimit ATC. Nga zbatimi i marrëveshjeve konfidenciale, deri në fund të vitit 2023, reduktimi përllëgaritet sa 1/5 e rimbursimit me çmimet e miratuara të këtyre barnave.

Përfundime: Në Shqipëri, me hyrjen në fuqi të Listës së Barnave të Rimbursueshme (LBR) për vitin 2018, dhe në vazhdim, me hyrjen në fuqi të LBR 2019 dhe LBR 2021, janë lidhur dhe zbatuar, marrëveshje për reduktimin e çmimit të barnave të rimbursuara, me mbajtësit e autorizimit për tregtim. Zhvillime të mëtejshme pritet të ndodhin në këtë drejtim me hyrjen në fuqi të akteve të reja ligjore për miratimin e llojeve dhe procedurave të lidhjes së Marrëveshjeve të Posaçme (MEA).

Fjalët kyçe: barna të rimbursuara, negociim i çmimeve të barnave, marrëveshje me mbajtësit e autorizimit për tregtim

MEKANIZMI DIVERGJENT I 1,4 NAFTAKINONEVE DHE POTENCIALI ANTIKANCEROGJEN, ANTIBAKTERIAL, ANTIFUGAL I TYRE

Dafinë Kastrati Bajçinca

Hyrje : Naftakinonet janë veçanërisht prezente në familjet Bignoniaceae, Verbenaceae dhe Proteaceae. Në organizmat e gjallë, 1,4-NQ-të përfshijnë një klasë produktesh natyrore që përmbajnë një unazë 1,4-naftalenoide (metil, hidrosil dhe/ose zëvendësime metoksi). Prandaj, zhvillimi i strategjive kimioterapeutike që përfshijnë agjentë të rinj antitumoralë me molekula të vogla ka qenë zona e fokusit të kimioterapisë së kancerit si një strategji tjetër për të luftuar dhe kontrolluar incidencën e kancerit. Të dyja, kinonet natyrore dhe analogët e tyre janë burime jetike të komponimeve citotoksike. Antibiotikët antraciklin (daunorubicin, doxorubicin, idarubicin dhe mitoxantrone), bleomicina, daktinomicina dhe mitomicina-C janë shembuj të kinoneve që janë përdorur klinikisht për kimioterapinë e kancerit. Këtu në përshkruajmë mekanizmat më të fundit të veprimit të raportuar deri më tani për 1.4 - naftokinonet si një efekt antikancerogjen, antibakterial dhe antifungal.

Qëllimi: Përmbledhja e efekteve antikancerogjene të 1,4-NQs dhe mekanizmi i veprimit që mund të përdoret për terapinë kundër kancerit, efektet antibakteriale dhe antifungale të derivateve të 1,4-NQ.

Rezultatet dhe konkludimet Naftakinonet veprojnë si agjentë antikancerogjenë përmes një morie mekanizmash të përfshirë në të gjitha llojet e kancerit. Disa nga më të rëndësishmit që janë eksploruar deri më tani dhe që janë raportuar gjerësisht në literaturë janë dëmtimi i ADN-së përmes gjenerimit të ROS, frenimi i topoizomerazës II, rregullimi i faktorit supresor të tumorit p53 dhe induksioni i apoptozës nëpërmjet ERS. Në këtë

përmbledhje, përshkruhet se 1,4-NQ mund të mbrojnë neuronet dhe mikroglia përmes aktiviteteve të tyre të fuqishme anti-ROS dhe anti-inflamatore. Rezultatet treguan se derivatet e reja 1,4-NQ penguan përhapjen e qelizave të kancerit të mëlçisë Hep3B dhe HepG2. Derivatet sintetikë të 1,4 NQ mund të përdoren potencialisht për të trajtuar sëmundjet dhe për t'u përdorur si pesticide.

Fjalët kyçe: 1,4-NQ, efekte antikancerogjene, antibakteriale dhe antifungale

FARMAKOEKONOMIA SI MJET PËR TË PËRMIRËSUAR QASJEN NË TERAPI INOVATIVE DHE KUJDESIN SHËNDETËSOR NË KOSOVË

Drilona Citaku Shaqiri

Farmakoekonomia si një disiplinë e rëndësishme studion efektivitetin dhe koston e barnave dhe trajtimin që ofrohet në sistemin shëndetësor. Këtu do të shqyrtohet roli i farmakoekonomisë në përmirësimin e qasjes në terapi inovative dhe në kujdesin shëndetësor në Kosovë.

Farmakoekonomia ofron informacione të rëndësishme për vendimmarrjen shëndetësore dhe për alokimin e burimeve. Duke identifikuar trajtimet më kosto efektive dhe duke vlerësuar vlerën që ato sjellin për kujdesin e pacientit, farmakoekonomia lejon politikbërësit dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor në Kosovë të marrin zgjedhjet e duhura lidhur me adoptimin dhe financimin e terapive inovative.

Në një skemë shëndetësore të karakterizuar nga burime të kufizuara dhe nevoja të larta shëndetësore, farmakoekonomia ofron një mjet për të optimizuar qasjen në terapi të nevojshme dhe për të përmirësuar efikasitetin e ofrimit të kujdesit shëndetësor. Përdorimi i analizave farmakoekonomike në zhvillimin e politikave shëndetësore, udhëzimeve klinike dhe monitorimit të performancës mund të ndihmojë në zvogëlimin e barrës për sistemin shëndetësor dhe në përmirësimin e rezultateve shëndetësore për popullsinë në Kosovë.

Gjatë këtijë przentimi do të mundohemi të theksojmë rëndësinë e farmakoekonomisë si mjet për të përmirësuar qasjen në terapi inovative dhe kujdesin shëndetësor në Kosovë si dhe për të adresuar sfidat e sistemit shëndetësor në një mënyrë më efikase dhe të qëndrueshme në aspektin financiar.

Fjalë kyqe: Farmakoekonomia, Terapi inovative, Strategji,

RADIOLIGANDËT NË ONKOLOGJI: PËRMIRËSIMI I DIAGNOSTIKIMIT DHE STRATEGJIVE TË TRAJTIMIT

Erlis Jacellari

Në ditët e sotme, në fushën e onkologjisë, kërkimi për mjekësinë precize ka çuar në përparime të rëndësishme në strategjitë diagnostike dhe terapeutike. Radioligandët janë shfaqur si opsione të pazëvendësueshme në këtë drejtim, duke ofruar mundësi të pashembullta për imazherinë precize dhe terapinë e synuar. Ky abstrakt eksploron rolin thelbësor të radioligandëve në onkologji, duke u përqëndruar veçanërisht në aplikimin e tyre në diagnostikim dhe trajtim.

Teknikat e imazherisë me radioligandë, siç janë tomografia me pozitron (PET) dhe tomografia kompjuterike me foton të vetëm (SPECT), u japin klinicistëve metoda jo-invazive dhe shumë të ndjeshme për të vizualizuar tumoret dhe monitoruar përparimin e sëmundjes dhe vlerësim të përgjigjes ndaj trajtimit në shumë lloje të ndryshme të kancerit.

Për më tepër, terapia me radioligandë (RLT) ka revolucionarizuar strategjitë e trajtimit të kancerit duke shpërndarë rrezatimin drejtpërdrejt te qelizat tumorale duke kursyer dëmtimin e indeve të shëndetshme. Radioligandët e synuar, si terapia me radionuklid të receptorëve të peptidit (PRRT) dhe terapia e synuar ndaj antigenit të membranës specifike për prostatë (PSMA), kanë demonstruar efikasitet të jashtëzakonshëm te pacientët me tumore neuroendokrine, kancer prostate dhe kancerë të tjerë që shprehin targete/receptorë molekularë specifikë.

Ky punim thekson ndikimin transformues të radioligandëve në onkologji, duke nënvizuar potencialin e tyre për të përmirësuar rezultatet e pacientëve dhe për të riformatuar të ardhmen e kujdesit ndaj pacientëve me kancer. Megjithëse është shpejt për të materializuar teknologjinë e radioligandëve në Kosovë, është e rëndësishme ndërgjegjësimi dhe promovimi i përqsasjeve inovative, të bazuara në radioligandë, pasi kanë potencialin për të riformatuar vizionin e onkologjisë precize në Kosovë dhe përtej dhe kujdesin ndaj pacientit.

Fjalet Kyce: Radioligandë, Onkologji, Kanceri i prostatës

EFIKASITETI I PASTAVE TË DHËMBËVE ME ZBARDHUES DHE ROLI I FARMACISTIT NË KËSHILLIM

Editë Elezi

Përshtatja e njerëzve me modernizimin ka rritur kërkesat e një higjienë dhe kujdesi vetjak perfekt duke zhvilluar akoma më tej fushën e estetikës. Kujdesi për t'u dukur bukur ka vënë në pah rëndësinë e estetikës së dhëmbëve duke çuar në avancim akoma më tej të teknikave dhe metodave kuruese, korrigjuese e zbardhuese. Punimi jonë ka për qëllim të paraqesë shkallën e përdorimit dhe efikasitetin e pastave zbardhuese të dhëmbëve. Për të arritur këto rezultate zhvilluam studime në pacientë fizikë përkatësisht në dy klinika dentare në qytetet e Tiranës dhe Prishtinës.

Më tej është kryer shqyrtimi i literaturave shkencore për të patur më nga afër një qasje të ndikimit të pastave me agjentët zbardhues përsa i përket efekteve anësore të mundshme. Duhet patur parasysh që jo gjithmonë kemi të bëjmë me dhëmbë natyralë në momentin e aplikimit të pastave.

Në përfundim, në bazë të mënyrave të studimit të sipërpërmendura kuptuam hapësirën, rëndësinë dhe ndryshimin që sjellin pastat zbardhuese sot.

Fjalët kyçe: pastë dhëmbësh, pastë dhëmbësh zbardhuese, agjentët zbardhues, materiale restauruese, zbardhja e dhëmbëve

OPTIMIZIMI I MENAXHIMIT FARMACEUTIK NË KUJDESIN SHËNDETËSOR: PËRQASJE INTEGRALE PËR EFIKASITET DHE SIGURI

Xhenita Podrimcaku

Kujdesi shëndetësor ndryshon ndjeshëm për shkak të përparimeve të shpejta teknologjike dhe nevojave të rritura të pacientëve. Në këtë kontekst, menaxhimi farmaceutik luan rol thelbësor në sigurinë dhe efikasitetin e kujdesit shëndetësor.

Ky studim ka për qëllim të analizoj përqasjet integrale për optimizimin e menaxhimit farmaceutik në kujdesin shëndetësor. Duke kombinuar aspektet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), praktikat klinike dhe qasjet e menaxhimit të burimeve, ky hulumtim përpiqet të përmirësojë shërbimin farmaceutik në mjekësi dhe efikasitetin e tij.

Në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e këtij hulumtimi, është realizuar studimi i literaturës bashkëkohore dhe mbledhja e të dhënave, përmes një pyetësi elektronik. Përmes përdorimit të teknologjive inovative, analizës së të dhënave dhe implementimit të standardeve të sigurisë, ky studim synon të ofrojë një rrugë të qëndrueshme për të rritur qasjen e pacientëve në medikamente dhe të sigurojë administrimin e efektiv të tyre.

Me përjasje të integruara dhe përdorimin e metodave të avancuara të menaxhimit, hulumtimi përpiqet të adresojë sfidat komplekse të menaxhimit farmaceutik dhe të përmirësojë shërbimin për të gjithë përdoruesit e sistemit shëndetësor.

Fjalë kyçe: Menaxhimi, Optimizimi, Kujdesi, Teknologjia

SIMPOZIUM ROCHE - LUFTA E PËRBASHKËT KUNDËR KRIMIT ME PRODUKTE FARMACEUTIKE

Pius Waldmeier

MENAXHIMI I PACIENTËVE ME KANCER TË GJIRIT ME INHIBITOR TË CD4/6: PRAKTIKAT AKTUALE DHE PERSPEKTIVAT NË ONKOLOGJI”

Valbonë Rrahmani

Kanceri i gjirit është një nga sëmundjet më të zakonshme në botë që prek gratë, dhe përparimet në trajtimin e tij janë jetike për përmirësimin e mbijetesës dhe cilësisë së jetës së pacientëve. Inhibitorët e ciklinës D-kinazës 4/6 (CDK4/6) kanë luajtur një rol të rëndësishëm në menaxhimin e kancerit të gjirit me receptorë estrogjeni (ERpozitiv), duke ofruar një qasje më të avancuar dhe të synuar për trajtimin e sëmundjes.

Ky punim paraqet një përmbledhje të praktikave më të mira dhe strategjive në përdorimin e inhibitorëve të CDK4/6 për menaxhimin e pacientëve me kancer gjiri. Inhibitorët e CDK4/6 përdoren me sukses në kombinim me ET për pacientët me kancer të gjirit ER- pozitiv në faza të avancuara. Këto barna ndihmojnë në kontrollimin e rritjes së qelizave tumorale duke ndaluar ciklin qelizor në fazën G1, duke ngadalësuar progresionin e sëmundjes dhe duke rritur mbijetesën pa progresion të sëmundjes.

Ky punim diskuton gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit ndërdisiplinor në trajtimin e kancerit të gjirit me CDK4/6i, duke theksuar edukimin e farmacistëve rreth këtyre trajtimeve inovatore, rolin e farmacistëve në edukimin e pacientëve për përdorimin korrekt të barnave, ndjekjen e trajtimit, dhe ndërmjetësimin midis pacientëve dhe mjekëve për të siguruar kujdes optimal.

Në këtë konferencë, synohet të prezantohen praktikat më të mira

për menaxhimin e pacientëve me kancer të gjirit që përdorin CDK4/6 inhibitorë, duke ofruar udhëzime të qarta dhe këshilla praktike për farmacistët në Kosovë dhe më gjerë.

Fjalët kyçe: Kanceri i gjirit, trajtimet inovative, CDK4/6 inhibitorët

SIGURIA E KONSERVUESVE NE EMULSIONET KOZMETIKE – NJE PERMBLEDHJE E KETYRE PRODUKTEVE NE TREGUN KOSOVAR

Kleidie Mustafa

Qëllimi: Studimi ynë synon të hedhë dritë mbi përmbajtjen e konservueseve në produktet kozmetike në tregun aktual dhe të vlerësojë rrezikun e tyre për shëndetin publik. Për këtë qëllim, kemi analizuar një gamë të gjerë të produkteve kozmetike nga një numër i ndryshëm i prodhuesve, duke u fokusuar në përmbajtjen e konservuesve dhe shpërndarjen e tyre në produkte. Përmes analizave statistikore të të dhënave, kemi identifikuar konservuesit sipas llojit të produktit kozmetik.

Materialet dhe metodat: Ky punim paraqet një hulumtim të kryer nga autori i këtij punimi dhe rishikim të literaturës shkencore. Për të arritur qëllimin e këtij punimi janë hulumtuar mbi 50 produkte të ndryshme kozmetike nga 10 prodhues që dminojnë më shumë në tregun tonë dhe janë krahasuar/mbështetur me punimet më të reja shkencore të botuara në revista të besueshme.

Rezultatet: Rezultatet tregojnë se kremrat janë produktet kozmetike më të pranishme në treg dhe përmbajnë shumicën e konservuesve. Tokoferoli dhe fenoksietanoli dalin si konservuesit më të përdorur, ndërsa parabenët shfaqen si konservues të pranishëm në një pjesë të relativisht të vogël të produkteve, veçanërisht në losione. Ndërsa shumica e konservuesve të përdorura janë vlerësuar si të sigurta për përdorim kozmetik, parabenët dalin si substancat

që mund të kenë rreziqe potenciale, veçanërisht kur përdoren në sasi të mëdha ose për periudha të gjata kohore. Për të garantuar një përdorim të sigurtë të produkteve kozmetike, harmonizimi ndërkombëtar është një hap i rëndësishëm drejt këtij qëllimi dhe do të ndihmonte në garantimin e sigurisë së konsumatorëve në nivel global.

Fjale kyçe: Kozmetike, Preparate kozmetike, Siguri, Konservues, Krema, Locione

PËRDORIMI I PRODUKTEVE QË PËRMBAJNË SQUFUR, BURIMI I UJIT TERMAL NË KOSOVË

Lendita Morina

Produktet që përmbajne sulfur zakonisht janë përdorur për trajtimin e akneve dhe problemeve të lëkurës. Megjithatë, për individët me alergji ndaj sulfurit, aplikimi i tyre mund të shkaktojë reaksione të naryshme të lëkurës, përfshirë skuqje dhe irritim të lëkurës. Është e rëndësishme të konsultoheni me një dermatolog për të gjetur alternativa të përshtatshme për trajtimin e alergjisë së lëkurës tuaj.

Uji termal është përdorur për të lehtësuar simptomat e semundjeve si riniti alergjik, sinuziti dhe probleme të tjera të frymëmarrjes. Pervoja e inhalimit të ujit termal përmes avujve mund të ndihmojë në shkëputjen e mukozës së mbushur, duke hapur rrugët e frymëmarrjes dhe për të lehtësuar frymëmarrjen.

Në shumë vende, qendrat turistike me burime uji termal ofrojnë shërbime të specializuara për trajtimin e sëmundjeve të frymëmarrjes, duke përfshirë edhe inhalimin e ujit termal.

Në hulumtim do të flitet për ujin termal me burim në Banje të Pejës, përkatësisht në Resortin Rehabilitues ONIX SPA, për përmbajtjet kimike dhe vetitë shëruese të tij, në veçanti aplikimi, për here të pare në Kosovë, i ujit termal në formë inhalimi

METODA E SHPEJTË KONFIRMUESE PËR PËRCAKTIMIN E MBETJEVE TË SULFONAMIDEVE NË QUMËSHT ME ANË TË EKSTRAKTIMIT NË FAZË TË NGURTË DHE KROMATOGRAFISË SË LËNGT-BASHKË ME SPEKTROMETRINË E MASËS

Gjylai Alija

Përdorimi global i barnave farmaceutike është rritur në mënyrë të vazhdueshme. Agjentët antimikrobikë kanë qenë veçanërisht të rëndësishëm në trajtimin modern të sëmundjeve mikrobike. Sulfonamidet janë ilaçe antimikrobiale me spektër të gjerë që përdoren shpesh për të parandaluar dhe trajtuar infeksione ose sëmundje dhe si nxitës të rritjes së efikasitetit të ushqimit. Këto barna mund të lënë mbetje në qumësht nëse përdoren ilegalisht.

Mbetjet e sulfonamidit janë metabolitë që ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut. Ato mund të rezultojnë në pasoja të rrezikshme, efekte kancerogjene, reagime alergjike të njerëzimit me mbindjeshmëri, çekuilibër të mikroflorës së zorrëve dhe rezistencë bakteriale në shëndetin publik. Kufijtë maksimalë të mbetjeve (MRL) për këto kimikate janë përcaktuar nga Bashkimi Evropian për të garantuar sigurinë ushqimore dhe për të parandaluar ekspozimin e konsumatorëve. Në këtë studim është paraqitur metoda e shpejtë konfirmuese për përcaktimin e mbetjeve të sulfonamideve në qumësht. Mbetjet e barnave (Sulfamethoxazol, Sulfachloropyridazin, Sulfadiazin, Sulfadimetoksina, Sulfadimidin dhe Sulfafurazol) u ekstraktuan duke përdorur McIlvaine dhe TCA 20%, por pastrimi i mëtejshëm i ekstraktimit në fazën e ngurtë u krye në Oasis HLB.

Instrumenti ishte i pajisur me një sondë jonizimi me elektrospërkatje (ESI+) në polaritet pozitiv dhe katërpolësh të trefishtë. Ndarja kromatografike u krye në kolonën C18 dhe siguroi rezolucion të kënaqshëm brenda kohës më të shkurtër të ekzekutimit. Për marrjen e kromatogrameve u përdor mënyra e monitorimit të reagimit të shumëfishtë (MRM). Pas kushteve kromatografike, kushteve

MS/MS dhe optimizimit të teknikës së ekstraktimit, parametrat e vlefshmërisë: lineariteti, selektiviteti, CC α , CCB, saktësia dhe preciziteti i metodës LC-MS/MS janë vërtetuar në përputhje me standardet e përshkruara në Vendimin e Komisionit 2002 /657/EC. Metoda e paraqitur këtu demonstroi linearitet adekuat me koeficientët e korrelacionit mbi $r^2 \geq 0,98$ për të gjitha sulfonamidet e analizuar. Përqendrimi i mbetjeve ishte mbi LOQ, por nën nivelet maksimale të vendosura nga BE. Monitorimi i mbetjeve farmaceutike është i nevojshëm për të mbrojtur shëndetin e njeriut. Metoda mund të përdoret për analiza rutinë për identifikimin dhe përcaktimin sasior të sulfonamideve në mostrat e qumështit.

Fjalët kyçe: Mbetjet e sulfonamideve, optimizimi, vlefshmëria, metoda LC-MS/MS

RISHIKIMI I LEGJISLACIONIT FARMACEUTIK DHE IMPLEMENTIMI I POLITIKAVE EFIKASE TË PËRFSHIRJES SË SHËRBIMIT FARMACEUTIK NË KUJDESIN SHËNDETËSOR

Merita Dauti

Hyrje: Kujdesi farmaceutik përbën një ndër hallkat më të rëndësishme të kujdesit shëndetësor duke kontribuar në ngritjen e cilësisë së shëndetit si dhe uljen shpenzimeve publike në sistemin shëndetësor. Për zbatimin e suksesshëm të kujdesit farmaceutik duhet që autoritetet kompetente të zhvillojnë dhe zbatojnë një

kuadër politikash si dhe ndryshimesh në aktet ligjore me qëllim që të sigurohet që farmacistët të jenë në gjendje të kontribuojnë në kujdesin e pacientëve dhe ofrimin e shërbimeve në çdo mjedis të kujdesit shëndetësor ku përdoren barna. Ndryshimet ligjore të viteve të fundit në mbarë territorin europian si dhe në vendet e rajonit paraqesin një tendencë pozitive në gjithëpërfshirjen e farmacistëve në kujdesin shëndetësor duke zgjeruar numrin e shërbimeve që mund të ofrohen në farmaci. Kjo gjithashtu përbën dhe një sfidë për farmacistët për ta dëshmuar profesionalizmin e tyre duke dëshmuar aftësitë e tyre profesionale në shërbimet shëndetësore.

Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të evidentojë të gjitha ndryshimet ligjore dhe politikave të ndërmara në vendet e BE -së dhe vendet e rajonit në drejtim të përfshirjes së farmacistëve në kujdesin shëndetësor si dhe të analizojë benefitet e implemenitimit në praktikë të shërbimeve të ofruara nga farmacistët

Metodat: Një kombinim i metodave përshkruese dhe analitike duke përdorur të dhëna cilësore nga institucionet përkatëse me të cilat janë arritur vlerësime konkrete. Burimet e informacionit janë marrë nga institucionet relevante në vend si Agjensioni i barnave, Oda e farmacistëve dhe Fondi për Sigurime Shëndetësore si dhe EMA, OBSH, FIP dhe raportet vjetore nga institucionet përkatëse.

Rezultatet: Në të dhënat e viteve të fundit, rezultojnë se në BE në vitin 2020 ishin të punësuar mbi 410,000 farmacistë. Rreth 55% e farmacistëve punojnë në farmacitë e rrjetit të hapur. Shërbimet që ofrohen në farmaci në vendet e BE-së janë të shumta në drejtim të parandalimit të sëmundjeve, parandalimin e faktorëve të riskut, edukimin e pacientëve mbi përdorimin racional të barnave, adherimin e terapive etj. Të gjitha këto shërbime ofrohen në bashkëpunim me institucionet shëndetësore dhe Fondet për Sigurime Shëndetësore të cilat rimburojnë shërbimet e ofruara

Konklusion: Nga rezultatet e studimit konkludojmë që ekziston një potencial i mjaftueshëm dhe gatishmëri nga farmacistët për të ndërmarrë role të reja. Përvojat nga vendet europiane flasin për

shërbime të reja që ofrohen në farmaci si dhe rezultate të arritura në kujdesin shëndetësor.

Fjalë kyçe: shërbimi farmaceutik, farmacist, kujdesi shëndetësor, korniza legjislative

NJË STUDIM RAST I NJË PACIENTI ME LIMFOMË DIFFUZE TË MËDHA ME QELIZA B

Flaka Rexha

Ky punim shtjellon studimin e rastit të një pacienteje femër të diagnostikuar me Limfomë Difuze të Qelizës B të Madhe (DLBCL), duke studiuar marrëdhënien e ndërlikuar ndermjet DLBCL, sistemit imunitar dhe sistemit limfatik. Unë kam ekzaminuar tërësisht procesin diagnostik, fazat e trajtimit dhe ndikimet në rajonet e hundës dhe sinusit dhe nyjet limfatike.

Hulumtimi synon të kuptojë në mënyrë gjithëpërfshirëse rrugëtimin e pacientëve të diagnostikuar me DLBCL, duke u fokusuar në proceset e diagnostikimit, ndikimet e trajtimit dhe zhvillimin e tumorit. Nëpërmjet një qasjeje të metodave të përziera me elementë kualitativ, studimi analizon të dhënat nga viti 2020 deri në vitin 2022, duke plotësuar boshllëqet në kuptimin e përparimit të sëmundjes. Duke përdorur një metodë të përzier me komponentë kualitativ, studimi kryen një analizë krahasuese dhe rishikim të literaturës bazuar në raporte nga departamente të ndryshme mjekësore.

Fokusi është në procedurat diagnostike, efektet e trajtimit në fiziologji dhe evolucionin e tumorit përmes testeve mjekësore. Punimi shqyrton udhëtimin e pacientit dhe tregon efektivitetin e kimioterapisë R-CHOP, terapisë me rrezatim dhe Neupogen në menaxhimin e DLBCL. Unë u fokusova në teknikat e imazherisë që gjurmonin përparimin dhe regresionin e sëmundjes, ndërsa stabiliteti hematologjik kundërshtonte luhatjet e qelizave të bardha të gjakut ndikuar nga administrimi i Neupogen.

Unë kam bërë Interpretim Radiografik për të nxjerrë në pah kompleksitetin në rajonet e hundës dhe sinusit dhe nyjet limfatike. Ky rast studimi ofron njohuri të vlefshme për diagnozën, trajtimin dhe përparimin e pacientëve me DLBCL, duke theksuar rëndësinë e të kuptuarit të dinamikës së sistemit imunitar dhe limfatik në menaxhimin efektiv të sëmundjes.

Studimi është fokusuar në kimioterapinë R-CHOP, terapinë me rrezatim dhe Neupogen si role vendimtare në menaxhimin e sëmundjes, me interpretimet radiografike që hedhin dritë mbi kompleksitetin e sëmundjes.

Fjalë kyçe: Sistemi imunitar, Sistemi limfatik, DLBCL, Diagnostikimi, Trajtimi.

ADERIMI I BARNAVE – ÇFARË DINË STUDENTËT E FARMACISË NË KOSOVË PËR TË?

Lindita Aliaga - Poster prezantim

Informacion i rëndësishëm

Important information

Pergjegjësia mbi përmbajtjen e punimeve është përgjegjësi individuale e autoreve. Organizatori nuk përmban përgjegjësi për përmbajtjen e këtyre punimeve.

Responsibility for the content of the works is the individual responsibility of the authors. The organizer is not responsible for the content of these works.

ABDIIBRAHIM



one
GROUP



PROMED



delta

P H A R M A

